

Vendimet e Komisionit disiplinor
Prishtinë, datë , 17. 10. 2019

Komisioni disiplinor; Dukagjin Zefi – kryetar, Luan Salihu, anëtar dhe Avni Shala , anëtar

LIRIDON LECI ; lojtar I klubit të futbollit “ **Drita** “ nga Gjilani , në procedurë të hapur disiplinore nga mbledhja e kaluar e komisionit, për sjellje të gabuara pas përfundimit të ndeshjes ; **KF “ Drenica “ – FC “ Drita “** e zhvilluar në stadiumin “ Bajram Aliu “ në Skenderaj (raportet zyrtare), bazuar në nenin 40 paragrafi 1 pika 1 të Rregullores disiplinore ; **denohet** me shqiptimin e masës disiplinore ; **verejtje e fundit.**

SC “ GJILANI “ nga Gjilani , në procedurë të hapur disiplinore nga mbledhja e kaluar e komisionit, për hedhje të një shishe të PVC nga ana e spektatorëve të saj në drejtim të asistentit në ndeshjen ; **SC “ Gjilani “ – KF “ Dukagjini “** e zhvilluar në stadiumin e qytetit në Gjilan (raportet zyrtare), bazuar në nenin 51 paragrafi 1 pika 1 të Rregullores disiplinore ; **denohet** me shqiptimin e masës disiplinore ; **verejtje e fundit.**

FC “ LLAPI 1932 “ nga Podujeva në procedurë të hapur disiplinore nga mbledhja e kaluar e komisionit, për lëshime në organizimin e ndeshjes ; **FC “ Llapi 1932 “ – KF “ Ferizaj “** e zhvilluar në stadiumin “ Zahir Pajaziti “ në Podujevë (raportet zyrtare), bazuar në nenin 52 paragrafi 1 pika 3 të Rregullores disiplinore ; **denohet me zhvillimin e 2 (dy) ndeshjeve të radhës në fushën e vet pa prezencë të spektatorëve.**

BURIM ZHJEQI ; ndihmës trajner në klubin e futbollit “ **Llapi 1932** “ nga Podujeva , në procedurë të hapur nga mbledhja e kaluar e komisionit , për në ndeshjen **FC “ Llapi 1932 “ – KF _ Ferizaj “** e zhvilluar në stadiumin “ Zahir Pajaziti “ në Podujevë (raportet zyrtare) , bazuar në nenin 40 paragrafi 2 pika b/3 të Rregullores disiplinore ; **denohet me ndalesë në kryerjen e detyrës së trajnerit për 4 (katër) ndeshje zyrtare** sipas radhës të organizuara nga ana e Federatës së Futbollit të Kosovës.

MENTOR ZHDRELLA ; lojtar i klubit të futbollit “ **Llapi** “ nga Podujeva “ në procedurë të hapur disiplinore nga mbledhja e kaluar e komisionit, për ndëshkim me karton të kuq (raportet zyrtare ; për start i cili është në kundërshtim me rregullat ekzistuese të lojës së futbollit) në ndeshjen : **FC “ Llapi 1932 “ – KF “ Ferizaj “** e zhvilluar në stadiumin “ Zahir Pajaziti “ në Podujevë, bazuar në nenin 42 paragrafi 1 pika 1 të Rregullores disiplinore ; **denohet me ndalesë loje për; 3 (tri) ndeshje zyrtare** sipas radhës të organizuara nga ana e Federatës së Futbollit të Kosovës.

KORAB HASANI ; lojtar i klubit të futbollit “ **LIRIA** ” nga Prizreni me numër të ID kartelës; 001600M91 dhe licencuar në Federatën e Futbollit të Kosovës me numër të fanelës sportive 8, në procedurë të inicuar disiplinore nga ana e komisionit të garave, për ndëshkim me karton të kuq në ndeshjen ; **KF “ Liria ” – KF “ Dardana ”** e zhvilluar në stadiumin “ Perparim Thaqi ” në Prizren (raportet zyrtare), bazuar në nenin 39 paragrafi 3 të Rregullores disiplinore ; **denohet me ndalesë loje për ; 2 (dy) ndeshje** zyrtare sipas radhës të organizuara nga ana e Federatës së Futbollit të Kosovës.

ARMENT KASTRATI ; lojtar i klubit të futbollit “ **DARDANA** ” nga Kamenica, me numër të ID kartelës ; 001524M87 dhe licencuar në Federatën e Futbollit të Kosovës me numër 19, në procedurë të inicuar disiplinore nga ana e komisionit tëve, për ndëshkim me karton të kuq në ndeshjen **KF “ Liria ” – KF “ Dardana ”** e zhvilluar në stadiumin “ Perparim Thaqi ” në Prizren (raportet zyrtare), bazuar në Rregulloren disiplinore neni 39 paragrafi 3 ; **denohet ; me ndalesë loje për ; 2 (dy) ndeshje zyrtare** sipas radhës të organizuara nga ana e Federatës së Futbollit të Kosovës.

KF “ VËLLAZNIMI ” nga Gjakova në procedurë të inicuar disiplinore nga ana e komisionit të garave për leshime në organizimin e ndeshjes ; **KF “ Vellaznimi ” – KF “ Vllaznia ”** e zhvilluar në Gjakov (raportet zyrtare), bazuar në nenin 32 paragrafi 1 të Rregullores disiplinore ; **I hapet procedura disiplinore** deri në kompletimin e lëndës Kërkohen raportet plotsuese nga personi për siguri dhe zyrtaret e ndeshjes. Afati datë 21.10.2019.

MENTOR HIKMENGJAJ ; lojtar i klubit të futbollit “ **Vellaznimi** ” nga Gjakova me numër të ID kartelës; 009835M00 dhe licencuar në Federatën e Futbollit të Kosovës me numër të fanelës sportive 17, në procedurë të inicuar disiplinore nga ana e komisionit të garave, për ndëshkim me karton të kuq (raportet zyrtare; fyerje dhe kapje për fanelë e gjyqtarit Vigan Iberdemaj) në ndeshjen ; **KF “ Vellaznimi ” – KF “ Vllaznia ”** e zhvilluar në stadiumin e qytetit në Gjakovë , bazuar në nenin 41 paragrafi 2 pikë b/1 të Rregullores disiplinore ; **denohet me ndalesë loje për; 4 (katër) ndeshje** zyrtare sipas radhës të organizuara nga ana e Federatës së Futbollit të Kosovës.

KESHILLA JURIDIKE

Pala e pakenaqr në këto vendime ka të drejtë ankese drejtuar komisionit disiplinor të shkallës së dytë , komisionit për ankese në afatin kohor prej ; 8 (tetë) diteve nga data e sjelljes së këtij vendimi – publikimit të tij në faqen zyrtare të Federatës së Futbollit të Kosovës. Ankesa e ushtruar nga ana e Palës së ankumuar nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit.

Prishtine, datë, 17.10.2019

Kryetari, Dukagjin Zefi

